



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

## FTESË PËR PJESËMARRJE

### MUNDËSI PJESËMARRJE NË PANAIR NDËRKOMBËTAR

Në datat 29 Janar-1 Shkurt 2018 do të zhvillohet në Kuvajt Panairi 10-të Ndërkombëtar i Shpikjeve në Lindjen e Mesme.

Panairi organizohet nga Qendra Shkencore Kuvajtiane në bashkëpunim me Panairin Ndërkombëtar të Gjenevës nën kujdesin personal të Emirit të Kuvajtit, Sheikh Sabah Al-Ahmed Al-Jaber Al-Sabah.

Bordi drejtues i Qendrës Shkencore Kuvajtiane fton shpikësit dhe institucionet e specializuara të vendit tonë të marrin pjesë në këtë panair dhe të prezantojnë shpikjet e tyre, me qëllim pasurimin e panairit. Shpikjet, të cilat do të vlerësohen si më të mirat do të shpërblehen me vlera monetare deri në 50 000\$.

Tarifa e regjistrimit dhe pjesëmarrjes në panair është 500\$ për shpikësin.

#### **TARIFA E REGJISTRIMIT**

Në tarifën e regjistrimit përfshihen:

1. Lëshimi i vizës
2. Prezantimi i shpikësit në dy gjuhë (arabisht dhe anglisht)
3. Hapësira brenda ambienteve të panairit (2x2 m<sup>2</sup>)
4. Tavolina me karrige për prezantimin e shpikjes
5. Akomodimi në hotel me 4 yje
6. Pritja në aeroport dhe transporti në hotel
7. Transporti i brendshëm
- 8.

#### **AKTIVITETET**

Panairi i 10-të Ndërkombëtar i Shpikjeve është një event unik në llojin e tij në Lindjen e Mesme, me interes rajonal, arab dhe ndërkombëtar. Në këtë panair ftohen të gjithë shpikësit për të prezantuar shpikjet e tyre, me qëllim pasurimin e panairit.

## **DATA E ZHVILLIMIT TË PANAIRIT**

Panairi do të zhvillohet në datat 29 Janar – 1 Shkurt 2018

***Adresa: Kuvajt***

## **REGJISTRIMI**

Regjistrimi në panair bëhet përmes faqes së internetit [www.iifme.com](http://www.iifme.com).

## **VLERËSIMI I FITUESVE**

Shpikjet do të vlerësohen nga anëtarët e jurisë së përbërë nga personalitete të specializuara në fushën e inovacionit shkencor dhe shpikjeve.

## **ÇMIME**

Për shpikjet fituese do të shpërndahen çmime me vlerë monetare 50 000\$